# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-473379**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Fier/ Mbante automatik dhe 29 fishekë në banesë, arrestohet 66-vjeçari! Sekuestrohet edhe një “Benz”, rezulton në kërkim nga Interpol |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/fier-mbante-automatik-dhe-29-fisheke-ne-banese-arrestohet-66-vjecari-sek-i588686` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 09:59:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 10:10:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `098455b446b03944d8d278cd0baef34fe03f933c431910363f52c8db3c55b87e` |
| TEKSTI | `8446b466ba62c6fa66792f984561bf070040b4ff7a438bae928d471b070ec6ff` |
| PAMJA | `b05c925362998e872378ee5db9faa81ae6bddd2a18b5321b970d82c0e2385bdb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f9403ae4c252d1da86b4e3e19b1fe943035eb6b2a5ffcaeb37c7a6c9904464ce` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `48d5adc2dc979f83a887c219539e18c9885fc52000dc610804adb08caf975432` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f9403ae4c252d1da86b4e3e19b1fe943035eb6b2a5ffcaeb37c7a6c9904464ce`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English



# Fier/ Mbante automatik dhe 29 fishekë në banesë, arrestohet 66-vjeçari! Sekuestrohet edhe një “Benz”, rezulton në kërkim nga Interpol

TemA

27 Shtator 2026, 12:10Kronika TEMA




Në operacionin e koduar “No Guns 5”, shërbimet e Komisariatit të Policisë Fier arrestuan në flagrancë një 66-vjeçar, me inicialet R. M., banues në Fier, i dyshuar për posedim të paligjshëm të armës së zjarrit.

Gjatë kontrollit në banesën e tij, policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri tip automatik, si dhe një krehër me 29 fishekë luftarakë

Ndërkohë, Seksioni për Hetimin e Trafiqeve në DVP Fier zhvilloi një tjetër operacion për verifikimin e burimit të të ardhurave të përdorura për blerjen e automjeteve luksoze

Gjatë kontrolleve, u ndalua për verifikim një automjet tip “Benz”, i prodhuar në vitet e fundit. Pas verifikimeve, automjeti rezultoi i shpallur në kërkim nga Interpol Manchester.

Për këtë rast është proceduar në gjendje të lirë 26-vjeçari E. D., banues në Mallakastër, për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”.

Policia njofton se kontrollet dhe operacionet do të vijojnë për evidentimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, si dhe trafikimit të mjeteve motorike. Materialet procedurale janë referuar në Prokurorinë e Fierit për veprime të mëtejshme.

DVP Fier/ Finalizohen 2 operacione në fushën e armëmbajtjes pa leje dhe në kuadër të verifikimit të automjeteve luksoze.

Sekuestrohen një armë zjarri automatike, municion luftarak dhe një automjet luksoz.

Vihet në pranga 66-vjeçari që posedonte armën e zjarrit në banesë.

Procedohet penalisht 26-vjeçari që kishte në përdorim automjetin.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Fier, në vijim të kontrolleve të intensifikuara për evidentimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, bazuar edhe në informacionet e siguruara në rrugë operative për një shtetas që dyshohej se posedonte armë zjarri në banesë, kanë finalizuar operacionin policor të koduar

"No Guns 5".

Në kuadër të këtij operacioni, u kap në flagrancë dhe u vu në pranga shtetasi R. M., 66 vjeç, banues në Fier.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri tip automatik dhe një krehër me 29 fishekë.

Ndërkohë, Seksioni për Hetimin e Trafiqeve në DVP Fier, në kuadër të operacionit për verifikimin e burimit të të ardhurave për blerjen e automjeteve luksoze, ndaloi për verifikim një automjet tip "Benz".

Gjatë verifikimeve, automjeti, prodhim i viteve të fundit, rezultoi i shpallur në kërkim nga Interpol Manchester.

Për këtë rast u procedua në gjendje të lirë shtetasi E. D., 26 vjeç, banues në Mallakastër, për veprën penale "Trafikimi i mjeteve motorike".

Vijojnë operacionet për goditjen e veprimtarive kriminale dhe evidentimin e rasteve të armëmbajtjes pa leje dhe trafikimit të mjeteve motorike.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

---


## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Emri i doli në SkyECC bashkë me Endrit Doklen, GJKKO lë në burg Bledar Cafin! Akuzohet për trafik droge dhe grup të strukturuar kriminal]

11:30 Kronika

[Hetimet për shpërndarjen e drogës pranë gjimnazeve të Tiranës, mes të dyshuarve edhe një ish-efektiv i policisë]

11:00 Kronika

Furgoni me 90 kilogramë kanabis ndalohet në Kakavijë, droga do të transportohej në Greqi

10:30 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.